

V E N D I M
Nr. 91, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 27.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.232/5 Akti që i përket:

K ë R K U E S:GENCI MUHARREMI, përfaqësuar nga avokatët Vasil Dode e Kujtim Capo, me prokurë.

O B J E K T I:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar:

- Vendimet e gjykatave kanë deklaruar fajësinë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, duke shkelur nenin 32/2 të Kushtetutës. Kështu, gjykata, ka lexuar thëniet e të dëmtuarit, të bëra gjatë hetimit, pa e pyetur atë në seancë gjyqësore;

- Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në Dhomën e Këshillimit, është në kundërshtim me Kushtetutën. Në rekursin drejtuar kësaj Gjykate, janë parashtruar shkaqe ligjore, gjë që investonte këtë Kolegj ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore. Procesi jo i rregullt ligjor qëndron në faktin se duke mos e shqyrtuar çështjen në një seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, kërkuesi i është mohuar e drejta e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Elbasanit, me vendimin nr.38, datë 18.4.2000, ka deklaruar fajtor kërkuesin Genci Muharremi për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, parashikuar prej neneve 76 e 22 të Kodit Penal dhe e ka dënuar me 7 vjet burgim.

Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.135, datë 26.6.2000, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me vendimin nr.167, datë 27.2.2001, të marrë në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Genci Muharremi, si të pabazuar në ligj.

Në këto kushte, i mësipërmi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit Penal, duke pretenduar se ky vendim është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor.

Nga shqyrtimi i kësaj çështje në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin

se shkeljet e pretenduara nga kërkuesi, si elementë të një procesi jo të rregullt ligjor, nuk rezultojnë të bazuara. Kështu, kërkuesi ka pretenduar se, në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës, gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Konkretnisht, i mësimi ka parashtruar se gjykata e rrethit ka shkelur rregullat procedurale lidhur me leximin në seancën gjyqësore të thëniesve të të dëmtuarit Danil Sadiku. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se Kodi i Procedurës Penale, në nenin 369, lejon leximin e akteve që përmbahen në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor, në rastet që parashikohen në këtë dispozitë. Nëse ka qenë ose jo rasti për leximin e thëniesve është një çështje fakti dhe, në rastin në shqyrtim, gjykata e rrethit ka pranuar se plotësohen kushtet për aplikimin e kësaj dispozite.

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë nga ana e tij janë parashtruar shkaqe ligjore për prishjen e vendimeve dhe për këtë shkak, çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese vëren se është e vërtetë se në rekurs është parashtruar se vepra penale e kryer nuk duhej cilësuar si vrasje e mbetur në tentativë, por si plagosje e lehtë me dashje, duke analizuar se mungon ana subjektive e figurës së krimit të vrasjes. Por, Gjykata konstaton se nga pikëpamja e rrethanave të faktit, kërkuesi e pranon ngjarjen ndryshe nga gjykatat. Në këto kushte, ky pretendim, megjithëse në dukje jep përshtypjen e një pretendimi ligjor, në substancë është pretendim për prova dhe, duke qenë i tillë, nuk përbën element të një procesi të parregullt ligjor.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.